VENDIM
Nr.71, datë 12.10.2011

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA DEGA E BANKËS ALPHA-ALBANIA/ALPHA BANK-ALBANIA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", të nenit 43 shkronja "e", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 23 pikat 1 dhe 3, të nenit 24 pika 1 shkronja "ç", të nenit 54 pika 2 shkronja "d", të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Dega e Bankës Alpha-Albania/Alpha Bank-Albania të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

- "Ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve".

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Degës së Bankës Alpha-Albania/Alpha Bank-Albania, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani